

MUSHKËRI TË GJELBRA PËR QYTETET TONA



This project is funded by
the European Union






MUSHKËRI TË GJELBRA PËR QYTETET TONA

Fushata Monitoruese për
Cilësinë e Ajrit dhe Zhurmave
në Stacionet e Autobusave

Zona e Monitoruar: Tiranë



This project is funded by
the European Union



RËNDËSIA E TË DHËNAVE

Në situatën aktuale të kontekstit shqiptar, të kërkosh të dhëna për mjedisin është një sfidë e cila kërkon shumë kohë dhe mund për shkak të mungesës së praktikave monitoruese të transparencës. Kjo, për vetë faktin se jetojmë në një situatë ku paqartësitë dhe pasiguritë janë tashmë pjesë e realitetit dhe duhet përshtatur me to. Në këtë mënyrë mund të kemi një kornizë të qasjeve që duhet të ndjekë çdo individ për t'u përshtatur me ndryshimet që ndikojnë mbi mjedis si dhe politikave mjedisore që duhet të ndjekë çdo shtet.

Mungesa e të dhënave mbi situatën mjedisore është një nga elementët thelbësorë që e vështirëson këtë proces si dhe ndikon në transparencën dhe informimin e publikut mbi çdo ndryshim që lidhet me këtë fushë, si një nga çeshtjet më të nxehta jo vetëm në Shqipëri por kudo nëpër botë. Thënë kështu, është e rëndësishme të adresohet problemi i mungesës së të dhënave tek autoritetet përkatëse. Mungesa e informacioneve dhe praktikave monitoruese mund të kuptohet qartësisht si mekanizëm për të lejuar abuzimet dhe shkarkimet në mjedis.


Të dhënat mjedisore gjenerohen nëpërmjet monitorimit të komponentëve mjedisorë. Kjo do të thotë që nuk kemi një numër të konsiderueshëm monitorimesh të cilët të jenë të mjaftueshëm për të përpunuar dhe gjeneruar një informacion të saktë e të dobishëm për të bërë studime të mëtejshme si dhe për të marrë vendime për të përmirësuar situatën mjedisore ku ndodhemi.

Ekziston një nevojë e vazhdueshme për një informacion të besueshëm për të kuptuar situatën në të cilën ndodhemi, për të bërë parashikime e për t'i vërtetuar ato kundrejt ndryshimeve hapësinore dhe jo vetëm si dhe për të identifikuar e shmangur kërcënimet e mundshme sa më shpejt që të jetë e mundur. Për ta përmbledhur, kur flasim për mungesë të të dhënave mjedisore i referohemi:

- Të dhënave të papërpunuara e të papërditësuara
- Pamundësisë për t'i kthyer këto të dhëna në sinteza për vëmendje të autoriteteve vendimarrëse
- Mungesës së transparencës dhe informimit publik mbi çështjet që çenojnë mjedisin
- Vendimarrje e pa-bazuar në fakte/shkaqe

Si mund të qasemi ndaj këtyre mangësive dhe në të njëjtën kohë të jemi vigjilent mbi problemet mjedisore?

Në një formë apo në tjetrën, ajo për të cilën edhe është qëllimi kryesor i këtij publikimi është **“MONITORIMI I VAZHDESHËM MJEDISOR”**.



PSE NJË FUSHATË MONITORUESE PËR CILËSINË E AJRIT DHE ZHURMAVE?

Fushatat monitoruese mjedisore janë një mënyrë efikase për të mobilizuar dhe adresuar një shqetësim publik me një synim kryesor: atë të ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Kështu ngritja e një problemi të caktuar dhe adresimi i tij në vendin e duhur dhe në kohën e duhur duhet të ndikojë në politikat dhe praktikatat e organeve kompetente publike ose private.

Një fushatë e kësaj natyre jo vetëm që ndihmon të edukojë publikun për çështjen e cilësisë së ajrit, por gjithashtu shërben si një mënyrë për t'i nxitur e motivuar të flasin mbi çfarë i shqetëson, të japin mendime se si mund të përmirësohet situata si edhe të veprojnë e të përshtaten në mbështetje të ndryshimeve që lidhen me fushën e mjedisit. Kjo gjë jo vetëm që do të rriste frymën e bashkëpunimit midis publikut dhe autoriteteve publike apo private por do të rriste edhe nivelin e vigjilencës së qytetarëve mbi zonat më kritike për sa i përket cilësisë së ajrit dhe ndikimit në shëndetin dhe mirëqënien e gjithësecilit. Sa më shumë të ndërgjegjshëm të jenë njerëzit mbi rëndësinë e cilësisë së ajrit, aq më shumë do të jenë në gjendje të ndërmarrin masa dhe të ndryshojnë mënyrën e të jetuarit pro mbrojtjes së mjedisit.

Prandaj, qëllimet kryesore të realizimit të fushatave monitoruese për cilësinë e ajrit dhe zhurmave janë: arritja e ndërgjegjësimit mjedisor mbi si vetë njeriu dhe sektorë të ndryshëm ndikojnë në gjendjen e mjedisit; rëndësia e vizualizimit i të dhënave të përpunuara të thjeshtuara në mënyrë që të kuptohen nga kushdo dhe kuptimi i çfarë do të jepet si kontribut minimal për të reduktuar impaktet negative drejt mjedisit.

OBJEKTIVAT

1. Të kuptohet rëndësia e të paturit të dhëna mjedisore të përditësuar.
2. Të vlerësohet statusi i shëndetit publik duke u përqëndruar tek ekspozimi i popullatës ndaj ndotjes së ajrit si pasojë e përdorimit të transportit publik & privat dhe frekuentimit të hapësirave publike.
3. Identifikimi dhe vizualizimi i nivelit të ndotjes së ajrit përgjatë stacioneve kryesore urbane dhe vendodhjes me frekuentim të lartë nga popullata.

**TIRANA**

Fushata “Ndotja në një ditë të zakonshme”



Pas monitorimit të 4 parametrave të cilësisë së ajrit përreth institucioneve arsimore gjatë vitit 2019, në kuadër të projektit Mushkri të Gjëlbra në vitin 2020 është bërë monitorimi i cilësisë së ajrit në 40 stacione autobuzësh në Tiranë, bankomate, kioska dhe më konkretisht në akset e Unazës dhe ajo Kombinat-Kinsotudio të cilat frekuentohen nga një numër i madh qytetarësh të moshave të ndryshme.

LINJA E URBANIT UNAZA

Ndotësi Dyoksid Karboni (CO₂)

Sipas hartës shohim që të gjitha pikat e monitoruara tejkalojnë standardin Evropian për dioksidin e karbonit (350 ppm). 4 Stacionet të cilat tejkalojnë dyfish normën e BE-së janë:

Shkolla "Harry Fulz"; Kryqëzimi tek Farmacia 10,
Xhamia e Namazgjasë, Kryqëzimi i Rrugës së Elbasanit.




Shkarkimet nga automjetet, ndërtimet di edhe trafiku i rënduar, pozicionimi i stacioneve pranë kryqëzimeve dhe flota e vjetër e autobusëve bën që njerëzit që presin autobusin këto stacione të jenë shumë të ekspozuar ndaj ndotjes.

Ndotësi Dyoksid Azoti (NO₂)

Po ti referohemi hartës të gjeneruar me të dhënat e dioksidit të azotit të matura përgjatë unazës së Tiranës shohim që të gjitha pikat kanë një tejkalim të normave të BE-së (norma e lejuar nga BE 40 µg/m³). Përqëndrime të larta të NO₂ janë identifikuar në stacionet:

Farmacia 10; Zona e Brrylit;
Stacioni tek Tajvani; Godina tek Inxhineria e Ndërtimit.




Të gjitha këto stacione tejkalojnë me 2 ose 3-fish standardin e lejuar.

Ndotësi Grimcat e lmta PM 2.5)

Përsa i përket grimcave të pluhurave PM 2.5 standardi i BE-së është 25 $\mu\text{g}/\text{m}^3$, ndërsa matjet e realizuara nga ekspertët dhe vullnetarët e projektit Mushkëri të Gjëlbra tregojnë një tejkalim të standardit të lejuar në të 18 stacionet e unazës. Vlerat më të larta janë regjistruar tek stacionet:

Dispanceria; Zogu i Zi;
Xhamia e Namazgjasë; Ing. Ndërtimit.




Këto akse rrugore konsiderohen dhe si pika hotspot përsa i përket ndotjes në Tiranë. Po të shohim vlerat ka një tejkalim me 6-8 herë të standardit të lejuar. Grimcat e pluhurave PM2.5 kanë ndikim të drejtpërdrejt në shëndetin e njeriut dhe shkaktojnë problem me frymëmarrjen dhe sëmundje të tjera që lidhen me mushkëritë.

Ndotësi Grimcat e Pluhurit PM 10

Standardi i BE është $40 \mu\text{g}/\text{m}^3$ për pluhurat me diametër 10 mikron (PM10) të cilat ndikojnë në mënyrë negative në shëndetin e njeriut. Sipas monitorimit të realizuar përsëri identifikohet tejkalim i normave gjatë gjithë Linjës së Unazës. Vlerat fillojnë me $93 \mu\text{g}/\text{m}^3$ tek zona e Gjykatës dhe pallateve Agimi pra 2 herë më të larta se norma dhe vazhdon në pikat hotspot të evidentuara në grafikë.


Farmacia 10, Zona e Brrylit, Stacioni tek Tajvani, Godina tek Inxhineria e Ndërtimit.



Këto pika hotspot, në të cilat vlerat kanë arritur deri në $229 \mu\text{g}/\text{m}^3$ pra 6 herë më të larta se normat e lejuara, janë një tregues alarmi për të gjitha institucionet që janë përgjegjëse për monitorimin dhe marrjen e masave për një ajër të shëndetshëm dhe brenda standardeve të Bashkimit Evropian. Ndërkohë që qytetarët janë të ekspozuar ndaj ndotësve për minuta të tëra në këto ambjente dhe jo vetëm ndaj një treguesi por të disa prej tyre.

LINJA E URBANIT KOMBINAT - KINOSTUDIO

Linja e dytë e autobuzit të monitoruar në qytetin e Tiranës është Kombinat - Kinostudio e cila ka 22 stacione. Kjo është një ndër linjat më të rëndësishme në Tiranë, për shkak se rreth 10 milionë pasagjerë në vit përdorin këtë linjë autobuzi sipas burimeve ne media. Linja funksionon gjatë verës me orar 05:00- 24:00 dhe gjatë dimrit 05:00- 23:00. Kjo linjë stacionet fundore i ka në Kombinat dhe Restorant Molla pranë zonës së freskut.





Ndotësi Dyoksid Karboni (CO₂)

Dioksidi i karbonit sipas vlerave të matura tregon një tejkalim të normave në të 22 pikat e monitoruara. Pikat të cilat janë evidentuar si më problematike janë: Selvia; Dollari; Kisha Katolike dhe Tregu Ushqimor.

Stacioni: "Selvia", Stacioni: "Dollari"

Stacioni: "Kisha Katolike" Stacioni: "Tregu Ushqimor"







Të gjitha këto pika karakterizohen nga trafik i rënduar gjatë gjithë ditës.

Ndotësi Dyoksid Azoti (NO₂)

Po t'i referohemi hartës të gjeneruar me të dhënat e dioksidit të azotit të matura përgjatë kësaj Linje vemë re që të gjitha pikat kanë një tejkalim të normave të BE (40 µg/m³). Përqëndrime të larta të NO₂ janë vërejtur në stacionet: Ish-Kinostudio; Muzeu Historik; Misto Mame; QSUT.

Stacioni: "Ish-Kinostudio" Stacioni: "Muzeu Historik"
Stacioni: "Misto Mame" Stacioni: "QSUT"







Këto stacione janë vërtetë problematike për vlerat e matura.

Ndotësi Grimcat e Imta PM 2.5

Përsa i përket Grimcave të pluhurave PM_{2.5} standardi i BE-së është 25 $\mu\text{g}/\text{m}^3$, ndërsa matjet e realizuara nga ekspertët dhe vullnetarët tregojnë një tejkalim të standardit të lejuar në të 22 stacionet Linjës Kombinat - Kinostudio.

Stacioni: "Medreseja" Stacioni: "Selvia"
Stacioni: "Dollari" Stacioni: "Ruga Ura"






Vlerat në këto stacione kalojnë me 4-fish standardin e lejuar nga BE. Njerëzit janë tejet të ekspozuar dhe të rrezikuar nga niveli i lartë i pluhurave të evidentuara në këto zona. Përsa i përket pjesës tjetër të stacioneve përsëri kemi tejkalim të normës por me vlera më të ulta se stacionet e sipërpërmendura.

Ndotësi Grimcat e Pluhurit PM10

Standardi i BE-së për PM10 është 40 µg/m³, nga monitorimi i realizuar në terren rezulton që në linjen e autobusit Kombinat - Kinostudio asnjë stacion autobuzi nuk është brenda standardeve të lejuara.

Zona Selvi - Medrese



PËRFUNDIME

- Bazuar në të dhënat e cilësisë së ajrit të matura në Tiranë paraqitet se niveli i ndotjes është mbi normën e lejuar.
- Sektori i transportit dhe aktivitetet ndërtimore janë është kontribuesit kryesorë për sa i përket shkarkimeve dhe përqëndrimeve të ndotësve në ajër.
- Cilësia e ajrit në Tiranë në zonat kryesore urbane është përmirësuar vetëm gjatë periudhës së karantinës për shkak të pandemisë COVID-19. Megjithatë, me lirim të fashave orareve për lëvizjen e automjeteve, aktiviteteve të ndërtimit dhe ato industriale, niveli i ndotjes pësoi rritje të ndjeshme.
- Ndotësit kryesorë të ajrit janë grimcat PM10 dhe PM2.5 të cilat vijnë kryesisht nga shkarkimi i gazrave të automjeteve dhe kantierët e ndërtimit të cilat nuk të cilët nuk zbatojnë masat e monitorimit, raportimit dhe reduktimit të shkarkimeve në ajër.
- Bazuar në të dhënat tona nivelet të larta të NO2 janë vërejtur në rrugët dhe kryqëzimet kryesore të Tiranës ku është vërejtur një tejkallim me 5-6 herë të normave të lejuara të dioksidit të azotit (norma e lejuar nga BE 40 µg/m3) si pasojë e trafikut të rënduar të automjeteve.
- Vlerat e CO2 tek rruga e “Durrësit” dhe “Kavajës” tregojnë më shumë se dyfishin e vlerës (771 ppm) nga standardi Evropian (350 ppm) edhe pse janë zona janë të gjelbëruara në të dy anët e tyre.
- Njerëzit janë më shumë të ekspozuar ndaj ndotjes së ajrit në momentin kur ndodhen pranë stacioneve të linjave të ndryshme të autobusëve.

Për qytetarët të cilët përdorin qoftë në këmbë, me biçikletë apo nëpërmjet urbanit akset e unazës dhe kombinat kinostudio dhe që kanë probleme shëndetësore këshillohet që në këto kushte të minimizojnë ekspozimin e tyre ndaj ndotësve të pluhurit dhe dyoksidit të azotit pasi janë në vlera shumë të larta dhe përbëjnë rrezik të drejt për drejt për shëndetin publik.

Në kushtet kur përqëndrimi i ndotjes, prëgjatë gjithë vitit qëndron mbi normat e lejuara këshillojmë gjithashtu përdorimin e maskës pa dallim grupmoshe.


Vlerësohet që një qytetar në Tiranë (udhëtar, këmbësor, banor edhe punonjës) ekspozohet ndaj pluhurave dhe gazeve përtej standarteve të lejuara për pakëtn për 70minuta në ditë gjatë 250ditë të vitit.

ZHURMAT


Nëntor 2019 – Shkurt 2020

Përgjatë periudhës nëntor 2019 – shkurt 2020, në kuadër të projektit “Mushkëri të gjelbra për qytetet tona” është bërë monitorimi i nivelit të zhurmave në qytetin e Tiranës për dy linja të transportit publik: linja Unazës dhe linja Kombinat - Kinostudio. Përkatësisht, për linjën e Unazës janë monitoruar 39 stacione ndërsa për linjën Kombinat – Kinostudio janë monitoruar 12 stacione për të dyja anët përkatëse ku kalon kjo linjë. Grafikët më poshtë tregojnë rezultatet nga ky monitorim për të dy linjat përkatëse:

Grafik 1. Niveli i zhurmave (në dBa) për linjën e Unazës



Grafik 2. Niveli i zhurmave (në dBa) për linjën Kombinat – Kinostudio




Ajo që vërehet qartazi në të dy grafikët, për secilën nga linjat e monitoruara, është që në pothuaj çdo stacion të monitoruar ka një tejkalim të dukshëm të normës maksimale të lejuar gjatë ditës (55 dBa). Për linjën e Unazës, ndër stacionet më kritike paraqitet ai që ndodhet pranë qendrës tregtare “Ring Center” me vlerë maksimale 91.4 dBa. Kjo, për vetë faktin se ndodhet shumë pranë rrethrrrotullimit “Zogu Zi”, i cili është një pikat më problematike të qytetit të Tiranës ku grumbullohen një numër i madh automjesh private përgjatë mëngjesit dhe në pasdite. Një tjetër stacion problematik për sa i përket nivelit të lartë të zhurmave është ai që ndodhet përgjatë


rrugës së Elbasanit, përkatësisht tek kryqëzimi, ku arrin një vlerë maksimale prej 91.2 dBa. Gjithashtu, një stacion kritik me nivel të lartë të zhurmave me 88.4 dBa, është ai pranë shkollës 9 – vjeçare “Sabaudin Gabrani”, shkollë kjo e cila ndodhet shumë afër me kryqëzimin “21 Dhjetori” e cila paraqitet gjithashtu një nyje mjaft problematike për sa i përket trafikut dhe zhurmave që automjetet private dhe jo vetëm shkojnë në mjedis. Ndërsa për sa i përket linjës Kombinat – Kinostudio, niveli i zhurmave nuk arrin vlerat maksimale të linjës së Unazës. Megjithatë, përsëri këto vlera ndodhen mbi mesataren maksimale të lejuar. Përkatësisht, referuar grafikut të dytë, stacioni me vlera më të larta të ndotjes nga zhurmat paraqitet ai pranë poliklinikës nr. 9 drejt Kinostudios duke u pasuar me stacionin tek 9 katëshet, pranë qendrës së qytetit të Tiranës me vlerë maksimale 85.5 dBa.

Maj 2020 (përgjatë pandemisë globale COVID-19)

Grafik 3. Niveli i zhurmave (në dBa) për linjën e Unazës



Grafik 4. Niveli i zhurmave (në dBa) për linjën Kombinat - Kinostudio



Gjithashtu, monitorimi i nivelit të zhurmës për dy linjat “Unaza” dhe “Kombinat - Kinostudio”, janë monitoruar të njëjtat stacione por kësaj rradhe përgjatë periudhës së pandemisë globale COVID - 19, përkatësisht në muajin maj. Për linjën e Unazës vërehet një rënie e nivelit të zhurmave krahasimisht me matjet e kryera gjatë periudhës nëntor 2019 - shkurt 2020. Megjithatë, për këtë linjë niveli i zhurmave përsëri ndodhet mbi normat maksimale të lejuara, ku stacionet më kritike paraqiten ai që ndodhet pranë rrugës “Siri Kodra” (88.3 dBa), përsëri stacioni tek kryqëzimi i 21 dhjetorit (84.4 dBa) dhe stacioni pranë shkollës “Vasil Shanto (76.5 dBa). Ndërsa për linjën Kombinat - Kino

studio, situata paraqitet pothuaj e njëjtë me periudhën nëntor 2019 - shkurt 2020, edhe pse ishte një periudhë izolimi për shkak të pandemisë. Tanimë, stacioni me vlera më të larta paraqitet ai që ndodhet tek “Medreseja” me 84.2 dBA dhe ai që ndodhet tek “Tirana International Hotel”, në qendër të qytetit të Tiranës me 79.9 dBA. Arsyeja pse ndodhemi kaq shumë të ekspozuar ndaj zhurmave vjen si pasojë e përdorimit të madh të automjeteve private gjatë përditshmërisë si dhe nga sektori i ndërtimit, ku ky i fundit është zhvilluar shumë edhe pse vendi ka qenë në izolim të plotë.

PËRFUNDIME

- Në asnjë prej stacioneve të të dy linajve të monitoruara nuk është rregjistruar një vlerë e zhurmës e cila është pranë standartit të lejuar.
- Vlerësohet që të paktën 350000 qytetarë (udhëtar, këmbësor, banor edhe punonjës) ballafaqohen me shqetësimin psikik, emocional dhe orientues për shkak të ekspozimit për një kohë mbi 20min ndaj nivelit të lartë të zhurmës.
- Burimi kryesor i zhurmave janë ndërtimet, automjetet e tonazhit të rëndë dhe transportit si edhe motorrë e dërgesave të shpejta. Gjithashtu edhe përdorimi i tepruar i borisë në kushtet e një menaxhimi tepër të dobët të trafikut nga ana e autoritetit lokal dhe qëndror.
- Sygjerohet që në procesin e kolaudimit të automjeteve të përfshihet edhe kontrolli mbi gjenerimin e zhurmave si një mënyrë për të reduktuar qarkullimin e mjeteve të zhurmshme në zona urbane mjete. • Ekspozimi i popullatës tejkalon limitet dhe ISHP duhet të identifikojë impaktin që ka në shëndetin e popullatës.

Botimi Nr. 2 Korrik 2020

MUSHKËRI TË GJELBRA PËR QYTETET TONA

Projekti financohet nga “Delegacioni i bashkimit Evropian në Shqipëri”

Projekti zbatohet nga:

Co-PLAN, Insituti për Zhvillimin e Habitatit
Milieukontakt Shqipëri

Bashkëpunorë lokal të projektit:

Qendra EPER dhe Ekomjedisi Durrës; Klubi Ekologjik Elbasan; Green Center Shqipëri dhe Qendra e Informacionit Aarhus Shkodër

Perpunimi grafik

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Të drejtat e Autorit ©GREEN LUNGS 2020

Riprodhimi është i autorizuar me kusht që burimi të citohet. Më shumë informacion mbi “Mushkëritë e Gjelbërta” janë në dispozicion në faqen e internetit: <https://greenlungs.al/>

Shënim

Pikpamjet e shprehura në këtë publikim jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikpamjet e Bashkimit Evropian

**MUSHKËRI
TË GJELBRA
PËR QYTETET TONA**

GREENLUNGS.AL